

RREGULLORE E BURSAVE
NË
AKADEMIA "EVOLUCION"

Prishtinë 2019

Në zbatim të Statutit të Akademia "Evolucion" në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Shkollës) dhe mbështetur në të, Këshilli Drejtues miraton Rregulloren e Bursave.

Neni 1

Me qëllim të stimulimit për rritjen e cilësisë së studimeve, Akademia "Evolucion" ofron bursa studimi për studentët e saj.

Neni 2

Numri dhe vlera e bursave të ofruara caktohet përmes një vendimi nga këshilli akademik, me rastin e hapjes së konkursit për bursa.

Neni 3

Të drejtë konkurrimi për bursë kanë studentët e rregullt, studentë të cilët i kryejnë obligimet financiare sipas marrëveshjes në kontratë dhe të cilët i përmbushin detyrimet e tyre të parapara në nenin 66 të statutit të Akademia "Evolucion".

Neni 4

Përzgjedhja dhe renditja e bursistëve bëhet përmes këtyre kriterëve:

1. Suksesi gjatë studimit;
2. Vijnueshmërisë së ligjëratave dhe ushtrimeve;
3. Rregullsisë në pagesa;
4. Pjesëmarrja në aktivitete tjera të shkollës;
5. Marrja e provimeve në afatet e rregullta.

Neni 5

Bazuar në rezultatet e konkursit të bursave të paraqitura nga administrata e shkollës, Këshilli Akademik merr vendim për ndarjen e bursave për studentë në vlera të caktuara.

Neni 6

Vendimi i shpallur nga këshilli akademik është publik, dhe hyn në fuqi 10 ditë pas marrjes së vendimit në rast se nuk ka ndonjë ankesë me shkrim.

Neni 7

Vlera financiare e fituar nga bursa, zbritet nga obligimi financiar i studentit për vitit akademik në vijim, në këstet e fundit.

Neni 8

Bursa e fituar vlenë për 1 vit akademik.

Neni 9

Bursisti duhet të ruaj suksesin e tij, me qëllim të ruajtjes së bursës për vitin pasues.

Neni 10

Në rast të shkeljes së rendit shtëpiak apo kodit të mirësjelljes, studenti humb bursën e fituar.

Neni 11

Në rast të ndërprerjes (pauzimit) të studimeve, studenti humb bursën e fituar.

Neni 12

Kjo rregullore në fuqi me rastin e nënshkrimit të saj nga drejtori ekzekutiv.